

VENDIM
Nr.36, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP MES
FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË DHE FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullat e praktikave dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e grupit të punës për hartimin e draftit të marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatisë të gjithë procesin ligjor për publikimin dhe njoftimin e vendimit të marrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta